

Termat e Referencës: “Ekspert për krijimin e një Plani Menaxhimi për Shpellën e Trenit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP”, për AdZM Korçë, aktiviteti 2.3

1. Hyrje

Shpella e Trenit, pranë Liqenit të Prespës, në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP, është një me vlera të rëndësishme natyrore, kulturore dhe arkeologjike, e cila kërkon një Plan Menaxhimi për ruajtjen dhe promovimin e qëndrueshëm. . Një Plan Menaxhimi do të vendoste kufijtë e vizitorëve, do të përmirësonte infrastrukturën dhe do të përfshinte komunitetet lokale në turizmin e qëndrueshëm. Shtigjet e qarta, sinjalistika edukative dhe kontrolli i përgjegjshëm i mbetjeve do të siguronin ruajtjen dhe balancimin e saj me përfitime turistike, kjo në bashkëpunim edhe me palët e tjera.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP (PA_024), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për këtë qëllim dhe si rrjedhim kërkon për një ekspert që do të hartojë Planin e Menaxhimit për Shpellën e Trenit në park (PKP).

2. Objektivat

Objektivat kryesorë të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- Të prodhojë një Plan Menaxhimi për shpellën e Trenit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP.
- Hartimin e një plani të plotë menaxhimi për Shpellën e Trenit në PKP.
- Identifikimin e vlerave natyrore, kulturore dhe historike të sitit.
- Propozimin e masave për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të sitit.
- Krijimin e një strategjie për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe edukimin e vizitorëve në këtë sit.
- Dokumenti (Plani i Menaxhimit) do të ofrojë udhëzime praktike për Administratën e Zonave të Mbrojtura të Korçës (AdZM Korçë) dhe do të shërbejë si bazë për të monitoruar numrin e vizitorëve, për të parandaluar degradimin e mjedisit dhe për të ruajtur integritetin gjeologjik të shpellës si edhe nga dëmtimet, ndotjet dhe rreziqe sigurie.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Shpella e Trenit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për krijimin e një Plani Menaxhimi për Shpellën e Trenit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të realizojë një analizë të situatës aktuale të sitit Shpella e Trenit në PKP dhe sfidave të menaxhimit.
- Të krijojë një strategji për menaxhimin e biodiversitetit dhe ekosistemit në shpellë.
- Të hartojë rekomandime për ruajtjen e vlerave arkeologjike dhe kulturore të sitit.

- Të propozojë masa për reduktimin e ndikimeve negative nga vizitorët dhe aktivitetet e tjera njerëzore në këtë sit.
- Të përgatisë një plan veprimi me objektiva afatshkurtra dhe afatgjata për këtë sit.
- Produkti final (Plani i Menaxhimit i plotë) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkenca mjedisore, biologji, arkeologji, menaxhim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë të mëparshme në hartimin e planeve të menaxhimit për zona të mbrojtura ose vende me vlera natyrore dhe kulturore.
- Njohuri mbi praktikat ndërkombëtare për ruajtjen e ekosistemeve në shpella dhe zonat arkeologjike.
- Aftësi në analizën e politikave dhe kornizave ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final (Plani i Menaxhimit) **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për krijimin e një Plani Menaxhimi për Shpellën e Trenit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PKP, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 2.3 me objekt "Ekspert për krijimin e një Plani Menaxhimi për Shpellën e Trenit në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP" për AdZM Korçë lidhur me PKP, **parashikuar në vlerën maksimale 7,000 (shtatë mijë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.**

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).